



Bashkimi Evropian

KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN

UDHËZIME PËR TË

PROMOVUAR DHE

MBROJTUR GËZIMIN E

TË GJITHA TË

DREJTAVE TË NJERIUT

NGA PERSONAT LGBTI

(LEZBIKË, GEJ, BISEKSUALË, TRANSGJINORË  
DHE INTERSEKSUALË)

Takimi i Këshillit të punëve të jashtme  
Luksemburg, 24 qershor 2013

# I. Parathënie

## A. Arsye për veprim

1. Të drejtat e personave LGBTI janë të mbrojtura me ligjin ekzistues ndërkombëtar për të drejta të njeriut, edhe pse shpesh është i nevojshëm veprim specifik, për të siguruar gëzimin e plotë të të drejtave të njeriut nga personat lezbikë, gej, biseksualë, transgjinorë dhe interseksualë (LGBTI). Personat LGBTI kanë të drejtat e njëjta si të gjithë individët e tjerë — nuk janë krijuar të drejta të reja njerëzore për ata dhe atyre nuk duhet t'u mohohet asnjë e drejtë. BE-ja është angazhuar për parimin e universalitetit të të drejtave të njeriut dhe riafirmon se vlerat kulturore, tradicionale ose fetare, nuk mund të përdoren për të justifikuar asnjë formë të diskriminimit, duke përfshirë diskriminimin e personave LGBTI<sup>1</sup>.

2. BE-ja ka shqetësime serioze për atë se orientimi seksual dhe identiteti gjinor vazhdojnë të shfrytëzohen për të justifikuar shkeljet e të drejtave të njeriut në gjithë botën. Personat LGBTI përbëjnë një grup të rrezikuar, të cilët vazhdojnë të jenë viktimat e persekutimit, diskriminimit, ngacimit dhe keqtrajtimeve të mëdha, të cilat shpesh përfshijnë forma ekstreme të dhunës,

ndër ato edhe torturën dhe vrasjen. Diskriminimi i personave LGBTI shpesh ka rrënjët në normat shoqërore dhe rolet e perceptuara që përjetësojnë pabarazitë gjinore. BE ka shqetësim të veçantë se në disa vende, marrëdhëniet seksuale mes dy të rriturve të gjinisë së njëjtë dhe me pëlqimin e tyre, kriminalizohen dhe rrezikohen nga dënimi me burg ose dënimi me vdekje. Në vende të tjera, qeveritë e vendeve kërkojnë në mënyrë aktive të kufizojnë lirinë e tubimit, shoqërimin dhe të shprehjes të personave LGBTI.

3. Kornizat legjislative që mbrojnë personat LGBTI nga diskriminimi dhe krimet e urrejtjes, mungojnë në shumë vende, kurse diskriminimi në bazë të orientimit të vërtetë ose të perceptuar seksual ose identitetit gjinor, shfaqet në gjithë botën, atëherë kur personat LGBTI mundohen të kërkojnë punë, kujdes shëndetësor ose arsimim. Rrjedhimisht, diskriminimi mund të shkaktojë varfëri më të madhe në mesin e personave LGBTI.

4. Personat që punojnë për të avancuar të drejtat e njeriut për personat LGBTI

Këshilli  
miratoi  
udhëzimet  
në vijim:

4

janë mbrojtësit e të drejtave të njeriut dhe ata duhet të përfillen kur bëhet mbikqyrja e gjendjes së mbrojtësve të të drejtave të njeriut në vendet në zhvillim. Megjithatë, ekziston nevoja që nga njëra anë, bashkëbiseduesit të jenë të ndërgjegjshëm ndaj ndjeshmërive të veçanta të çështjeve LGBTI dhe nga ana tjetër ndaj dobësive të veçanta të personave LGBTI. Një përjasje konsistente, por bindëse, mund të ketë gjasa të ketë efekt më pozitiv sesa një qasje publike dhe konfliktuoze. Qasjet e hartuara në mënyrë specifike dhe strategjitë e vendeve për të drejtat e njeriut, do të jenë një mjet i rëndësishëm për të identifikuar mënyrën më të mirë drejt të ardhmes në kontekste të ndryshme të këtij aspekti.

## B. Qëllimi dhe fushëveprimi

5. BE-ja ka për qëllim të promovojë dhe të mbrojë të gjitha të drejtat e njeriut për personat LGBTI në bazë të standardeve ekzistuese ligjore ndërkombëtare në këtë fushë, duke përfshirë edhe ato që janë caktuar nga Kombet e Bashkuara dhe Këshilli i Evropës. Përmes mjeteve të ndryshme në dispozicion, në kuadër të veprimit të vet të jashtëm, duke përfshirë edhe instrumentet financiare nga institucionet e BE-së dhe Shtetet Anëtare, BE-ja do të mundohet që në mënyrë aktive të promovojë dhe mbrojë gëzimin e këtyre të drejtave.

6. Këto udhëzime kanë për qëllim që zyrtarëve të institucioneve të BE-së dhe Shteteve Anëtare të BE-së t'u ofrojnë udhëzime që do të përdoren në kontaktet me vendet në zhvillim dhe me organizatat ndërkombëtare dhe të shoqërisë civile, duke përdorur një qasje rast pas rasti, në mënyrë që të promovojnë dhe mbrojnë të drejtat e njeriut për personat LGBTI në kuadër të veprimeve të veta të jashtme. Ato mundohen të aftësojnë BE-në për të promovuar në mënyrë aktive të drejtat e njeriut për personat LGBTI, për të kuptuar më mirë dhe për të luftuar çdo lloj diskriminimi me të cilin përballen ata, dhe të reagojë ndaj shkeljes së të drejtave të tyre. Duke vepruar kështu, këto udhëzime do të kontribuojnë më tej për të përforcuar dhe mbështetur politikën e BE-së për të drejta të njeriut në përgjithësi.

7. Ky dokument vazhdon të ndërtojë Pajimet për të Promovuar dhe Mbrojtur Gëzimin e të gjitha të Drejtave të Njeriut nga personat LGBT (2010). Veçanërisht janë të rëndësishme udhëzimet mbi dënimin me vdekje; mbi torturën dhe trajtimin ose ndëshkimin tjetër mizor, johuman ose degradues; mbi mbrojtësit e të drejtave të njeriut; mbi promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijës dhe mbi dhunën ndaj grave dhe vajzave, si dhe luftimin e të gjitha formave të diskriminimit të tyre.

8. Bashkimi Evropian është fort i vetëdijshëm se promovimi i të drejtave të njeriut në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor në shumë fusha në gjithë botën, përfshirë këtu edhe brenda BE-së, mund të shkaktojë diskutime të ndjeshme. Megjithatë, me ndërtimin e vazhdueshëm të standardeve ndërkombëtare dhe kornizës së vet legjislativë, BE-ja është angazhuar në avancimin e të drejtave të njeriut për personat LGBTI, në mënyrë kuptimplote dhe me respekt. Këtë do ta bëjë duke marrë parasysh realitetet lokale ku mbrojtësit e të drejtave të njeriut duhet të avancojnë betejën e tyre.

## C. Definicionet dhe Korniza Ligjore

9. Personat LGBTI kanë të drejtat e njëjta njerëzore si të gjithë individët, duke përfshirë këtu edhe të drejtën për jo-diskriminim. Ky parim është definuar në një numër të madh të instrumenteve ndërkombëtare, dhe ka një fushëveprim të gjerë në zbatimin e vet. Në mënyrë të veçantë, në nivel global, ky parim është mishëruar në Nenet 2 dhe 26 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (ICCPR)<sup>2,3</sup> dhe Nenin 2 të Paktit Ndërkombëtar mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (ICESCR)<sup>4</sup> (shih Shtojca 1). Ky interpretim është përkrahur nga Organe të ndryshme të Traktatit të OKB-së dhe Raportues Specialë.

10. BE-ja në mënyrë unanime ka mbështetur Deklaratën e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara (UNGA) – dhjetor 2008, mbi të drejtat e njeriut, orientimin seksual dhe identitetin gjinor,<sup>5</sup> të cilën e mbështetën 68 vende nga pesë kontinente. Deklarata riafirmon parimin e jo-diskriminimit dhe dënon ekzekutimet, arrestimin arbitrar ose shkeljet e të drejtave të njeriut në bazë të orientimit seksual ose identitetit gjinor. BE-ja gjithashtu ka përkrahur deklaratat e përbashkëta në Këshillin për të Drejta të Njeriut në vitin 2006 dhe 2011, të cilat janë bërë në emër të 54 shteteve, respektivisht 85. Në vitin 2011, Këshilli i OKB-së për të Drejta të Njeriut miratoi rezolutën mbi të drejta të njeriut, orientimin seksual dhe identitetin gjinor, e cila u përkrah në mënyrë unanime nga Bashkimi Evropian i cili ngarkoi OHCHR të realizojë një studim që dokumenton ligjet dhe praktikat diskriminuese dhe aktet e dhunës ndaj individëve, në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor. Raporti gjithashtu jep një pasqyrë të përmbledhur të standardeve dhe obligimeve të zbatueshme ndërkombëtare.<sup>6</sup>

11. Në vitin 2010, shtetet anëtare të BE-së në Këshillin e Evropës përkrahën Rekomandimin e Komitetit të Ministrave për të drejta të personave LGBTI, i cili përfshinte një grup të plotë të masave për promovimin e të drejtave të njeriut për personat LGBTI në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës.<sup>7</sup>

12. Zyra e Komisionerit të Lartë për të Drejta të Njeriut<sup>8</sup>, Procedurat Speciale të OKB-së<sup>9</sup>, Organet e Traktatit për të Drejta të Njeriut<sup>10</sup> dhe Komisioneri i Këshillit të Evropës për të drejta të njeriut<sup>11</sup>, në punën e tyre u referohen Parimeve nga Yogyakarta, lidhur me zbatimin e ligjit për të drejtat e njeriut në lidhje me orientimin seksual dhe identitetin gjinor, një tekst jodetyrues i përpunuar nga një tubim i ekspertëve të pavarur, në vitin 2006.

13. Ligjet dhe politikat e BE-së sigurojnë barazi dhe jo-diskriminim në baza të orientimit seksual, të përcaktuar në Nenin 10 dhe 19 të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian (TFEU) dhe Nenin 21 të Kartës për të Drejta Fundamentale të Bashkimit Evropian (CFREU). Parimi themelor i BE-së për trajtim të barabartë, mbron edhe personat transgjinorë nga diskriminimi. Kjo është caktuar në Direktivën e Rimodeluar Gjinore të BE-së (2006/54/EC), në Direktivën e Mallërave dhe Shërbimeve Gjinore (2004/113/EC) dhe, me referencë të qartë për identitetin gjinor dhe të shprehurit e gjinisë, në Direktivën e BE-së për Kualifikim Azili (2004/83/EC) dhe në Paketën e BE-së për të Drejta të Viktimave (2011/0129).

## Definicionet e punës<sup>12</sup>

Akronimi **LGBTI** përshkruan një grup të ndryshëm të personave, të cilët nuk përputhen me nocionet konvencionale ose tradicionale të roleve gjinore të mashkullit dhe të femrës. Personat LGBTI ndonjëherë referohen edhe si "pakica seksuale, gjinore dhe trupore".

**Lezbike** është një femër e cila ndjen joshje të fuqishme fizike, romantike dhe/ose emocionale ndaj femrave të tjera. **Gej** shpesh përdoret për të përshkruar një mashkull, i cili ndjen joshje të fuqishme fizike, romantike dhe/ose emocionale ndaj meshkujve të tjerë, edhe pse termi mund të përdoret për të përshkruar edhe meshkujt gej, edhe lezbiket.

**Biseksual** përshkruan një individ i cili ndjen joshje fizike, romantike dhe/ose emocionale si ndaj meshkujve, ashtu edhe ndaj femrave.

**Transgjinorë** është termi që përshkruan personat, të cilët kanë identitet gjinor dhe/ose shprehje të gjinisë e cila dallon nga gjinia me të cilën janë lindur. Termi **interseksual** përfshin variacionet trupore në lidhje me standardet e themeluara kulturore për të qenit mashkull dhe femër, duke përfshirë variacionet në nivel të kromozomeve, gonadeve dhe organeve gjenitale.

**Orientimi seksual** i referohet kapacitetit të secilit person për joshjen emocionale dhe seksuale, dhe marrëdhënien seksuale me individë të gjinisë tjetër ose të njëjtë, ose me individë me më shumë se një gjini.

**Identiteti gjinor** i referohet çdo eksperience të thellë të brendshme dhe të jashtme të gjinisë së një personi, e cila mund ose nuk mund të korrespondojë me gjininë e caktuar gjatë lindjes..

# II. Udhëzimet Operative

## A. Fushat Prioritare të Veprimit

Për të promovuar dhe mbrojtur në mënyrë efektive të drejtat e njerut për personat LGBTI përmes veprimit të jashtëm të BE-së, BE-ja duhet të përqëndrohet në fushat në vijim:

### 1. Dekriminalizimi dhe Luftimi i ligjeve dhe politikave diskriminuese

15. Sot, rreth 80 shtete ende kriminalizojnë marrëdhëniet e të rriturve të gjinisë së njëjtë, duke përfshirë disa shtete që mund të shqiptojnë dënimin me vdekje. Kriminalizimi i këtillë është në kundërshtim me ligjin ndërkombëtar për të drejta të njeriut dhe paraqet shkelje të të drejtave të njeriut për personat LGBTI, duke përfshirë të drejtën për jetë, intimitet, liri, siguri dhe shëndet, si dhe lirinë e shoqërimit, tubimit dhe të shprehurit. Këto liri fundamentale zvogëlohen edhe nga iniciativat legjislative që kriminalizojnë diskutimin publik dhe/ose shprehjen e homoseksualitetit, duke përfshirë edhe ndalimin e “marsheve të

krenarisë”. Kriminalizimi i marrëdhënieve mes të rriturve të gjinisë së njëjtë (me pëlqimin e tyre) forcon paragjykimet ekzistuese, rrit stigmën, legjitimizon diskriminimin dhe mund të bëjë personat LGBTI më të rrezikuar nga abuzimet e të drejtave të njeriut dhe dhuna, duke përfshirë brutalitetin policor dhe rastet e torturës dhe forma të tjera të trajtimit mizor, johuman dhe degradues të personave LGBTI.

16. Masat ligjore, siç janë ligjet kundër prostitucionit, ligjet e bezdisjes dhe ndalimi i të ashtuquajturës ‘veshje karakteristike për gjininë e kundërt’, gjithashtu mund të ketë në shënjestër personat me variacion gjinor ose personat transgjnorë, dhe mund të përdoren nga personeli i ushtrimit të ligjit për të ndjekur penalisht personat transgjnorë, në bazë të identitetit të tyre gjinor ose shprehjes së gjinisë. Personat transgjnorë, dokumentacioni i të cilëve nuk pasyron gjininë e tyre të preferuar,

mund të dëmtohet gjatë kërkimit të drejtësisë – ku janë shkelur të drejtat e tyre.

17. BE-ja:

a. Duhet të dënojë në mënyrë aktive ligjet diskriminuese, politikat dhe praktikrat, duke përfshirë kriminalizimin e marrëdhënies së pajtuar të të rriturve me gjini të njëjtë ose me identitet transeksual, sidomos, përdorimin e dënimit me vdekje, torturës ose keqtrajtimit në këtë drejtim.

b. Duhet gjithashtu në mënyrë aktive të kundërshtojë kufizimet e tjera të qasjes në të drejtat e njeriut, veçanërisht iniciativat ligjore që kufizojnë të drejtën e lirisë së të shprehurit, shoqërimit dhe tubimit.

c. Duhet të punojë për të arritur dekriminalizimin e marrëdhënieve me pëlqim të të rriturve të gjinisë së njëjtë dhe transgjnorë dhe heqjen e praktikave diskriminuese ndaj të gjithë personave, duke përfshirë edhe personat LGBTI.

18. Veprimet e BE-së në këtë fushë duhet të udhëhiqen si vijon:

- Shqyrtimi i kujdesshëm, rast pas rasti, në mënyrën më të mirë të promovimit efektiv të të drejtave të njeriut për personat LGBTI dhe eliminimi i ligjeve, politikave dhe praktikave diskriminuese.
- Fokusimi i punës në ato shtete ku kriminalizohen marrëdhëniet e të rriturve të gjinisë së njëjtë (me pajtimin

e vet), identitetet transeksuale ose mbrojtja e tyre ose ku ka lëvizje për të ndryshuar legjislacionin ekzistues (në cilindo drejtim), diskutimin e çështjes dhe inkurajimin e shteteve për të bërë ndryshime legjislative në përputhje me të drejtën ndërkombëtare.

- Vënia e theksit të veçantë në situatat ku dënimi me vdekje është në fuqi, dhe/ose ku ushtrohet torturë dhe keqtrajtim ndaj personave LGBTI, dhe dënimi i këtyre praktikave në pajtim me Udhëzimet e BE-së mbi dënimin em vdekje dhe Udhëzimet e BE-së mbi torturën dhe trajtimet ose ndëshkimet tjeramizore, johumane ose degraduese.
- Konsultimi dhe marrja parasysh e qëndrimeve të komunitetit LGBTI në vendet e caktuara, për mënyrat më të përshtatshme të veprimit dhe reagimit.

### 2. Promovimi i barazisë dhe jodiskriminimit

19. Diskriminimi në bazë të orientimit seksual ose identitetit gjinor është çështja më e zakonshme me të cilën përballen personat LGBTI. Legjislacioni, politikat dhe praktikrat diskriminuese mund të gjenden në vendin e punës dhe në sferën publike, veçanërisht në lidhje me qasjen në kujdesin shëndetësor dhe arsim. Ky diskriminim mund të përfshijë çështje të ngacmimit dhe forma të tjera të përjashtimit. Diskriminimi dhe trajtimi i pabarabartë janë gjithashtu

forma që përdoren edhe në objektet e paraburgimit.

20. Dokumentet e dhura të identitetit janë një parakusht për gëzimin efektiv të një numri të madh të të drejtave të njeriut. Personat transgjiorë që nuk kanë dokumentacion të identifikimit ku theksohet gjinia e tyre e preferuar, mund t'u ekspozohen trajtimeve arbitrare dhe diskriminimit nga individët dhe institucionet. Në disa vende nuk është krijuar asnjë dispozitë për njohjen ligjore të gjinisë së preferuar. Në vende të tjera, kërkesat për njohjen ligjore të gjinisë mund të jenë të tepërta, siç është kërkimi i provave të sterilitetit apo shterpësisë, ndërhyrjet kirurgjike për ndërrimin e gjinisë, trajtimet hormonale, diagnozat e shëndetit mendor dhe/ose të jetuarit në gjininë e preferuar në një periudhë të caktuar (e ashtuquajtura 'pervojë e jetës së vërtetë').

21. Dispozitat ose praktikat e tilla të tepërta janë në kundërshtim me të drejtën për barazi dhe jo-diskriminim, siç thuhet në Nenet 2 dhe 26 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (ICCPR) dhe Neni 2 në Paktin Ndërkombëtar për të Drejta Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (ICESCR).

22. BE-ja duhet të denoncojë të gjitha format e diskriminimit që janë në kundërshtim me këto parime fundamentale.

23. Veprimet e BE-së në këtë fushë duhet të udhëhiqen nga:

- Inkurajimi i shteteve që të promovojnë barazi dhe jo-diskriminim në gëzimin e të gjitha të drejtave të njeriut nga personat LGBTI, duke përfshirë prezantimin e legjislacionit dhe politikave nacionale, rritjen e vetëdijes që promovon barazi dhe jo-diskriminim në vendin e punës, sektorin shëndetësor dhe në arsim.
- Identifikimi i situatave ku përkrahja politike dhe financiare e iniciativave qeveritare dhe jo-qeveritare për të promovuar jodiskriminim dhe barazi, do të siguronin vlerë të shtuar në këtë punë.

### **3. Luftimi i dhunës fobike ndaj LGBTI**

24. BE-ja ka shqetësimetë thella lidhur me dhunën fobike ndaj LGBTI, e cila dëmton parimet më themelore të të drejtave të njeriut. Një dhuna e tillë përfshin një spektër të gjerë të akteve të dhunshme, duke përfshirë vrasje, përdhunim, rrahje, torturim, trajtim ose ndëshkim mizor, johuman ose degradues, dhe sulmet fizike në hapësirë publike. Ndërsa aktet e dhunës gjithnjë e më shumë janë duke u trajtuar nga organizatat për të drejta të njeriut; ato vazhdojnë të mbeten shumë pak të raportuara. Në disa vende, klima e mosndëshkimit lejon që aktet e dhunës ndaj personave LGBTI, të mbeten pa u

ndëshkuar dhe pa u hetuar. Vendet që vazhdojnë të kriminalizojnë marrëdhëniet e të rriturve të gjinisë së njëjtë dhe transgjiorë – me pëlqimin e tyre, ose mungesa e legjislacionit që mbron qartë personat LGBTI nga diskriminimi dhe dhuna, kanë shkallë dukshëm më të lartë të dhunës fobike ndaj LGBTI.

25. Dhuna dhe vrasjet transfobike janë veçanërisht të përhapura, duke marrë parasysh përqindjen relativisht të vogël të personave transgjiorë, nivelin e ulët të mbikqyrjes dhe raportimit të krimeve të këtilla si dhe frikën nga hakmarrja.

26. Femrat lezbike, biseksuale dhe transeksuale janë shënjestra të rrezikuara nga vrasjet dhe dhunimi i motivuar nga paragjykimet, si rezultat i pabarazisë gjinore dhe normave gjinore brenda strukturave familjare. Praktika e 'përdhunimit korigjues' dhe 'vrasjeve të nderit', të cilat shpesh ndodhin në mjedise private dhe kryhen nga anëtarët e familjes, është raportuar nga mbajtësit e mandatit të procedurave të posaçme të OKB-së dhe nga organizatat për të drejta të njeriut në shumë vende.

27. BE-ja synon të kontribuojë në luftimin e të gjitha llojeve të dhunës fobike ndaj LGBTI.

28. Veprimet e BE-së në këtë fushë duhet të udhëhiqen nga:

- Inkurajimi i shteteve që të njohin dhunën fobike kundër LGBTI dhe bashkë me shoqërinë civile të zhvillojnë masa ligjore dhe masa të tjera për parandalimin, mbikqyrjen dhe ndjekjen penale efektive të autorëve të dhunës fobike kundër LGBTI.
- Kontributi për të luftuar të gjitha format e dhunës fobike ndaj LGBTI, duke përkrahur iniciativat qeveritare dhe të shoqërisë civile për: mbikqyrjen e rasteve të dhunës, për të edukuar personelin e zbatimit të ligjit dhe për të kërkuar ndihmë dhe dëmshpërblim për viktimat e kësaj dhune.

### **4. Mbrojtja dhe përkrahja e mbrojtësve të të drejtave të njeriut**

29. Të gjitha shtetet duhet të respektojnë punën e mbrojtësve të të drejtave të njeriut siç thuhet në Deklaratën Ndërkombëtare për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Individit, Grupeve dhe Organeve të Shoqërisë për të Promovuar dhe Mbrojtur të Drejtat Fundamentale Universale (të miratuara në vitin 1998 nga UNGA). Megjithatë, mbrojtësit e të drejtave të njeriut (gazetarët, aktivistët, avokatët, sindikalistët, etj.) të cilët punojnë për të promovuar dhe për të mbrojtur të drejtat e njeriut për personat LGBTI, janë një grup jashtëzakonisht i rrezikuar dhe shpesh janë në shënjestër për ndjekje penale dhe shkelje të të drejtave të njeriut. Ky është veçanërisht rasti me vendet ku qeveritë ndalojnë

diskutimin publik për orientimin seksual dhe kufizojnë lirinë e shoqërimit dhe të shprehjes lidhur me këto çështje.

30. Në mënyrë që të jenë në përputhje me progresin e arritur në Udhëzimet e BE-së për mbrojtësit e të drejtave të njeriut, veprimet e BE-së në këtë fushë duhet të udhëhiqen si vijon:

- Duke inkurajuar vendet në zhvillim të miratojnë një kulturë të respektimit dhe pranimin të punës që e bëjnë mbrojtësit e të drejtave të njeriut, duke përfshirë edhe ato të personave LGBTI.
- Caktimi i prioritetëve për punën e BE-së në vendet ku respektimi i mbrojtësve të të drejtave të njeriut në përgjithësi dhe mbrojtësve të të drejtave të njeriut për personat LGBTI në veçanti, sidomos kur ndryshimet legjislative dhe sanksionet penale kanë pasur ndikim negativ në punën e mbrojtësve të të drejtave të njeriut.
- Duke reaguar ndaj shkeljeve të dukshme ndaj të drejtave të mbrojtësve të të drejtave të njeriut në vendet në zhvillim, duke theksuar qëndrimin e BE-së në lidhje me këtë çështje dhe kryerjen e punës së vet, në pajtim me Udhëzimet e BE-së lidhur me mbrojtësit e të drejtave të njeriut

## B. Mjetet operative

31. Zyrtarët e institucioneve të BE-së dhe Shteteve Anëtare të BE-së, kurdo që është me rëndësi, kanë mjete dhe veprime të ndryshme në dispozicion, dhe i shfrytëzojnë edhe instrumentet dhe udhëzimet në dispozicion:

### LIDHUR ME VENDET NË ZHVILLIM

#### 1. Strategjitë e vendeve për të drejta të njeriut:

- Trajtimi i situatës së personave LGBTI në strategjitë e vendeve për të drejta të njeriut, duke vënë në dukje në veçanti, shfaqjen e shkeljeve të të drejtave të njeriut dhe diskriminimin strukturor ndaj personave LGBTI. Ndaj këtyre çështjeve mund të kërkohet një qasje dhe fokusim i ndryshëm prioritar në vendet dhe rajonet e ndryshme.

#### 2. Mbikqyrja e të drejtave të njeriut për personat LGBTI:

- Shfrytëzimi i analizës /listës në Shtojcën 2, përtëndjekur dhe mbikqyrur situatën e të drejtave të njeriut për personat LGBTI në vendin e caktuar, për të identifikuar progresin/dështimet.
- Kontakti aktiv me autoritetet lokale, organizatat rajonale dhe organizatat lokale dhe ndërkombëtare të shoqërisë

civile, për të marrë informata që përfshijnë edhe shkeljet e të drejtave të njeriut për personat LGBTI.

#### 3. Raportet e Shefave të Misionit të BE-së:

- Përfshirja e një analize të situatës së personave LGBTI në raportet periodike, si dhe shkeljet e të drejtave të njeriut për personat LGBTI dhe mbrojtësit e të drejtave të njeriut.
- Identifikimi dhe mbikqyrja e rasteve individuale të shkeljeve flagrante të të drejtave të njeriut për personat LGBTI.
- Masat e detajuara (p.sh. demarshet, diskutimin e çështjes në dialogun politik, financimin) që janë ndërmarrë ose janë planifikuar për të luftuar kundër shkeljeve të pretenduara ose të vërtetuara (çdo veprim në rastet individuale duhet të vazhdojë vetëm me pëlqimin e personit në fjalë).

- Përdorimi i ciklit raportues UPR dhe vazhdimi i rekomandimeve të bëra për shtetin, nën shqyrtim.

#### 4. Demarshet dhe deklaratat publike:

- Propozimi dhe realizimi i demarsheve dhe deklaratave publike për çështjet LGBTI, me fokus të veçantë në rastet dhe situatat me rrezik të lartë.
- Reagimi ndaj zhvillimeve pozitive në

promovimin dhe mbrojtjen e gëzimit të plotë të të drejtave të njeriut për personat LGBTI në vendet në zhvillim.

- Përkrahja publike, duke përfshirë, sipas nevojës, pjesëmarrjen në ushtrimin e lirisë së tubimit dhe lirisë së shprehjes (p.sh., evenimentet publike, "marshet e krenarisë").

#### 5. Rastet individuale:

- Propozimi i veprimit specifik, p.sh. mënyrat e procedurës (demarshet), atëherë kur vetëdijësohen nga rastet individuale të dokumentuara me prova të shkeljes së të drejtave të njeriut për personat LGBTI (veprimet në rastet individuale duhet të përcaktohen mbi bazën e analizimit të rasteve në veçanti dhe duhet të vazhdohen nëse personi i caktuar jep pëlqimin e tij ose të saj të informuar dhe mund të formojë një pjesë të demarshit ose deklaratës).

#### 6. Seancat gjyqësore dhe vizitat në burgje:

- Mbikqyrja dhe pjesëmarrja në seancat gjyqësore gjatë procedurave ligjore që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut për personat LGBTI, duke i kushtuar vëmendje të veçantë rasteve me rrezik të lartë.
- Kontaktimi i prokurorit publik, autoriteteve policore ose ndonjë organ i themeluar dhe vizitues i pavarur, për të kërkuar leje për vizitë në qendër



paraburgimi, për shembull, për të vlerësuar gjendjen e personave LGBTI në paraburgim.

### **7. Dialogjet politike:**

- Diskutimi i situatës së të drejtave të njeriut për personat LGBTI në kuadër të komponentit të të drejtave të njeriut në dialogjet politike dhe dialogjet e specializuara (dialogjet për të drejtat e njeriut, konsultimet, nënkomitetet, dhe Neni 8 dialogjet Cotonou) me vendet në zhvillim dhe organizatat rajonale.
- Diskutimi i rasteve individuale të shkeljes së të drejtave të njeriut për personat LGBTI, me pajtimin e personave të involvuar.
- Inkurajimi i vendeve në zhvillim të iniciojnë ndryshime legjislative për të siguruar barazi para ligjit, për personat LGBTI.
- Inkurajimi i vendeve në zhvillim të nënshkruajnë dhe/ose ratifikojnë instrumente relevante ndërkombëtare, sidomos nga ICCPR dhe ICESCR, dhe heqja e rezervave relevante nga këto instrumente.
- Inkurajimi i vendeve në zhvillim për themelimin e organeve të pavarura, kompetente për mbikqyrjen e vendeve të privimit të lirisë, duke përfshirë ratifikimin e Protokollit Opcional të

Konventës kundër Torturës (OPCAT).

- Përdorimi i ciklit raportues UPR dhe vazhdimi i rekomandimeve që i janë bërë shtetit nën shqyrtim.
- Inkurajimi i vendeve në zhvillim të kërkojnë që Procedurat Speciale të OKB-së për të Drejta të Njeriut të realizojnë misione vendore dhe tematike, të pranojnë rekomandimet e tyre dhe t'i implementojnë ato.
- Përkrahja e atyre vendeve në zhvillim që janë në favor të promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut për personat LGBTI, inkurajimin e bashkëpunimit të ngushtë në forumet multilaterale dhe për të promovuar përpjekjet e tyre si shembuj në një nivel rajonal.
- Inkurajimi i këmbimit të informatave lidhur me praktikatat e mira me vendet në zhvillim që janë në favor të promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut për personat LGBTI, në mënyrë që të përmirësojë dhe të kontribuojë për masat e BE-së (që do të përfshihen në përmbledhjen e praktikave të mira dhe mësimëve të nxjerra).

### **8. Mbështetja e përpjekjeve nga shoqëria civile:**

- Ofrimi i mesazheve të mbështetjes politike kur konsiderohet e dobishme

dhe pas konsultimit me shoqërinë civile.

- Ofrimi i informatave për fondet në dispozicion (p.sh. me anë të EIDHR ose instrumenteve relevante të Shteteve Anëtare të BE-së).
- Ofrimi i informatave mbi ligjet dhe praktikatat që kanë të bëjnë me personat LGBTI në BE.
- Sipas nevojës, promovimin e dukshmërisë së organizatave lokale që promovojnë të drejtat e njeriut për personat LGBTI, p.sh. duke organizuar debate dhe seminare mbi çështjet relevante, me përfshirjen e aspekteve LGBTI dhe folësit, si dhe duke organizuar evenimente kulturore, konferenca, ose projekte sociale.
- Inkurajimi i një debati mbi çështjet LGBTI ndërmjet aktorëve shtetërorë dhe të shoqërisë civile, duke ofruar mundësi për këmbim.
- Konsultimi me organizatat e shoqërisë civile për mënyrën e integritit të çështjeve LGBTI.
- Inkurajimi i organizatave të shoqërisë civile në promovimin e të drejtave të njeriut për personat LGBTI.
- Inkurajimi i organizatave të shoqërisë civile për të dokumentuar në mënyrë të

dukur shkeljet e të drejtave të njeriut që dëmtojnë personat LGBTI.

- Përkrahja e hulumtimit relevant akademik për të ndihmuar në zhvillimin e debatit vendor dhe përpjekjeve të mbrojtjes.

### **9. Mekanizmat ndërkombëtarë:**

- Propozojnë që Raportuesit Specialë të OKB-së, Përfaqësuesit Specialë të BE-së dhe figurat ekuivalente nga Këshilli i Evropës, OSBE dhe organe të tjera rajonale për të drejta të njeriut, të takohen me organet rajonale për të drejta të njeriut dhe OJQ-të që promovojnë dhe mbrojnë të drejtat e njeriut për personat LGBTI.
- Propozojnë që organet ndërkombëtare mbikqyrëse të kenë përqëndrim special te personat LGBTI, gjatë vizitave të tyre në vende të privimit të lirisë.
- Inkurajimi i grupeve lokale për të përfshirë informata mbi situatën e personave LGBTI në raportet e tyre të ndërkëmbyeshme me mekanizmat rajonalë për të drejta të njeriut dhe me organet e OKB-së.
- Përfshirjen e informatave të tilla në materialet për përdorim në mekanizmin e Kontrollit Periodik në Këshillin e OKB-së për të Drejta të Njeriut.



## 10. Vizita e misioneve të BE-së dhe Shteteve Anëtare:

- Përfshirjen e informatave lidhur me situatën e personave LGBTI në materialet informuese për të vizituar misionet e BE-së dhe Shteteve Anëtare dhe inkurajimin e tyre për të diskutuar çështjen me homologët lokalë, si dhe takimin me mbrojtësit e të drejtave të njeriut që punojnë për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut për personat LGBTI.

32. Gjatë këtyre veprimeve, vëmendje e veçantë duhet kushtuar: rasteve me rrezik të lartë, duke përfshirë edhe rastet e dënimeve penale, dënimin me vdekje, torturën ose keqtrajtime të tjera; rastet e shkeljeve të pretenduara dhe të dëshmuara kundër mbrojtësve të të drejtave të njeriut për personat LGBTI; si dhe praktikën e mira të arritjes së ndryshimeve politike dhe ligjore dhe heqja e kufizimeve strukturore, duke përfshirë legjisllacionin dhe praktikën diskriminuese, si dhe mungesën e ndëshkueshmërisë për shkeljet e të drejtave të njeriut për personat LGBTI.

### NË FORUMET MULTILATERALE:

#### 1. Kombet e Bashkuara

- Shprehin nevojën që të gjitha vendet t'i përmbahen dhe të përputhen me

Deklaratën Universale për të Drejta të Njeriut (1948), ku parimi i universalitetit të të drejtave të njeriut është përcaktuar në Nenin 1, i cili shpall se 'të gjitha qeniet njerëzore lindin të lirë dhe kanë dinjitet dhe të drejta të barabarta'. Përfshirja e shqetësimeve LGBTI në deklaratat dhe pyetjet gjatë dialogjeve interaktive në OKB, duke reflektuar faktin se BE-ja është e shqetësuar thellë nga shkeljet e të drejtave të njeriut dhe lirive fundamentale në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor në përgjithësi, dhe dënon shkeljet specifike siç janë dënimi me vdekje mbi baza të tilla, ekzekutime jashtë-gjyqësore, përmbledhëse ose arbitrare, ushtrimi i torturës dhe trajtimeve ose dënimeve të tjera mizore, johumane dhe degraduese, arrestimi ose paraburgimi arbitrar, si dhe të drejtat për lirinë e të shprehurit, lirinë e shoqërimin dhe tubimit, dhe privimin e të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore në veçanti.

- Inkurajimi i shteteve që të marrin hapat e nevojshëm, sidomos masat legjislativë ose administrative, për të siguruar se orientimi seksual ose identiteti gjinor, në asnjë mënyrë nuk mund të jenë bazë për dënime penale, sidomos, ekzekutime, arrestime, paraburgim ose gjoba, të sigurojnë se shkelja e të drejtave të njeriut ndaj personave LGBTI do të hetohen kurse autorët do të përgjigjen para drejtësisë; si dhe të sigurojnë mbrojtje

adekuate për mbrojtësit e të drejtave të njeriut dhe heqjen e pengesave që i ndalojnë ata në kryerjen e punës së tyre.

- Sigurimi i një vazhdimi të përshtatshëm dhe të qëndrueshëm të rezolutës 17/19 të Këshillit për të Drejta të Njeriut (HRC), e cila është aktualisht e vetmja rezolutë e miratuar specifike për LGBTI, e cila ka vënë në lëvizje procesin e parë formal ndërqeveritar në lidhje me orientimin seksual dhe identitetin gjinor, duke kulminuar në panelin e HRC në muajin mars 2012. Raporti i Komisionerit të Lartë<sup>13</sup> dhe paneli kanë konfirmuar prevalencën dhe seriozitetin e dhunës dhe diskriminimit kundër personave LGBTI dhe kanë nxjerr në pah pamjaftueshmërinë e reagimit në nivel vendor dhe ndërkombëtar.
- Kur është e përshtatshme, të përshtatshme, të përshtatshme, të kushtuar për këto çështje, nga procedurat speciale të Këshillit për të Drejta të Njeriut dhe organet e Traktatit dhe të inkurajohen ata të vazhdojnë të integrojnë shqyrtimin e shkeljes së të drejtave të njeriut në bazë të orientimit seksual ose identitetit gjinor në mandatet e tyre përkatëse.
- Aty ku është me rëndësi, përfshirjen e pyetjeve dhe rekomandimeve LGBTI në intervenimet gjatë procesit UPR, në Këshillin e të Drejtave të Njeriut (HRC) në Gjenevë.

## 2. OSBE

- Kur është e përshtatshme, përfshirjen e shqetësimeve LGBTI në deklaratat nacionale dhe në pyetjet gjatë dialogjeve interaktive përbrenda OSBE-së.
- Vazhdimi i punës aktive për të përfshirë 'orientimin seksual dhe identitetin gjinor' si baza diskriminimi qartësisht të pranuar në Angazhimet e OSBE-së ose Vendimet e Këshillit Ministror.
- Në pajtim me angazhimin e shteteve pjesëmarrëse të BE-së për të këmbyer informata lidhur me heqjen e dënimit me vdekje dhe për ta vënë atë në dispozicion të publikut (Dokumenti i Kopenhagës), në deklaratat nacionale të Shteteve Anëtare të BE-së dhe në kuadër të kornizës së BE-së për Dimensionin Njerëzor – të përfshijnë informata mbi heqjen e dënimit me vdekje lidhur me personat LGBTI (masa të përfshira në Udhëzimet e BE-së për dënimin me vdekje).

## 3. Këshilli i Evropës (KiE)

- Kur është e përshtatshme, përfshirja e shqetësimeve LGBTI në deklaratat nacionale dhe në pyetjet gjatë dialogjeve interaktive në Këshillin e Evropës.
- Mirëpritja e rezultateve pozitive të iniciativave të Këshillit të Evropës në

këtë sferë dhe kontrollin e zbatimit të Rekomandimit CM/Rec (2010) 5.

- Aty ku është e përshtatshme, referimi i të drejtave të njeriut për personat LGBTI, kur KiE zhvillon mbrojtjen e të drejtave të njeriut, siç është Konventa e parandalimit dhe luftimit të dhunës kundër grave dhe dhunës familjare.
- Të merret parasysh se Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI) ka shprehur synimin e vet për të përfshirë kontrollin e çështjeve që kanë të bëjnë me LGBTI, në ciklin e tyre të ri të mbikqyrjes 2013.
- Aty ku është me rëndësi, të merret parasysh puna e Komisionerit për të Drejta të Njeriut, i cili ka vënë diskriminimin në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor, si një nga prioritetet e fushave tematike të Zyrës së tij.
- Aty ku është relevante, të merren parasysh rekomandimet e Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës (CPT), që kanë të bëjnë me trajtimin e personave LGBTI të privuar nga liria e tyre.

#### **4. Mekanizma të tjerë**

- Inkurajimi i organizatave relevante ndërkombëtare për të marrë hapa të

duhur për inkurajimin e shteteve që të ratifikojnë dhe të jenë në pajtim me normat dhe standardet relevante ndërkombëtare që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut për personat LGBTI.

- Inkorporimi, kur është e përshtatshme, i shqetësimeve për të drejtat e njeriut të personave LGBTI, në deklaratat dhe pyetjet gjatë dialogjeve interaktive në kuadër të mekanizmave ndërkombëtarë.
- Inkurajimi i vendeve të treta për të kërkuar procedura speciale për të drejtat e njeriut nga organizata të ndryshme ndërkombëtare, për të realizuar misione vendore dhe tematike, si dhe për të miratuar dhe implementuar rekomandimet e tyre.
- Kur është e mundur, të bëhen përpjekje për të bashkëpunuar në bazë ndër-rajonale, me organizimin e ngjarjeve anësore për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut për personat LGBTI, veçanërisht të diskutohen praktikat e mira për çështjet LGBTI, duke u kushtuar vëmendje të posaçme rekomandimeve të miratuara nga të gjitha organizatat e ndryshme ndërkombëtare dhe duke inkurajuar shtetet që t'i marrin parasysh ato, për të përmirësuar gjendjen e të drejtave njerëzore në nivel lokal për personat LGBTI.

- Identifikimi i shteteve me mendim të ngjashëm, për të avancuar barazinë e personave LGBTI, në gëzimin e të drejtave të njeriut, inkurajimin e bashkëpunimit të ngushtë në forumet multilaterale dhe promovimin e përpjekjeve të tyre si shembuj, në nivel lokal.
- Inkurajimin e Zyrës së Komisionerit të Lartë të OKB-së për të Drejta të Njeriut (UNOHCHR), subjekte të tjera të OKB-së, Këshillit të Evropës (KiE) dhe zyrat lokale të OSBE-së, që të trajtojnë çështjet e të drejtave të njeriut për LGBTI në punën e tyre.
- Përfshirjen e anëtarëve të shoqërisë civile në evenimente dytësore që marrin pjesë në forume multilaterale për të promovuar çështjet e të drejtave të njeriut për personat LGBTI.

# II. Masat e përgjithshme

33. Grupi Punues i Këshillit për të Drejta të Njeriut (COHOM) do të korrigjojë implementimin e këtyre Udhëzimeve tre vjet pas miratimit dhe nëse është e nevojshme, do t'i azhurnojë këto Udhëzime. COHOM gjithashtu do të promovojë dhe do të mbikqyrë integrimin e mëtejshëm të çështjeve LGBTI në suaza të veprimeve të jashtme të BE-së, do të shpërndajë këto Udhëzime në mënyrë aktive dhe do të promovojë implementimin e tyre nga Shtetet Anëtare të BE-së, Shërbimi Evropian për Veprime të Jashtme, misionet dhe operacionet e BE-së CSDP, dhe gjithnjë kur është me rëndësi, Përfaqësuesit Specialë të BE-së, Komisioni Evropian dhe Parlamenti Evropian.

34. COHOM do të përpilojë një përmbledhje të praktikave të mira dhe mësimet e fituara nga veprimet e BE-së në promovimin dhe mbrojtjen e gëzimit të plotë të të drejtave të njeriut nga personat LGBTI, në mënyrë që të promovojë mësimin e ndërsjellë dhe koherencën politike.

35. Informimi mbi çështjet LGBTI do të përfshihet në trajnimin përkatës për zyrtarët e institucioneve të BE-së dhe Shteteve Anëtare të BE-së, misionet e BE-së CSDP, diplomatët e Shteteve Anëtare të BE-së dhe personeli në terren.

36. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet aspekteve gjinore, d.m.th. duke marrë parasysh faktin se femrat lezbike dhe biseksuale, personat transgjitorë, interseksualë dhe personat me variante gjinore përbëjnë një pjesë të rëndësishme të grupit LGBTI dhe janë veçanërisht të rrezikuar nga dhuna në bazë gjinore dhe dhuna seksuale. Gjithashtu, grupet dhe organizatat e shoqërisë civile të grave shpesh luajnë një rol të rëndësishëm në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut për personat LGBTI, sidomos në vendet ku organizatat LGBTI nuk janë të lejuara.

## SHTOJCA 1

### **Instrumentet ndërkombëtare dhe rajonale ligjore, deklaratat dhe dokumente të tjera relevante për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut për personat LGBTI**

#### *Instrumentet ndërkombëtare ligjore:*

- Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike (ICCPR), 1966
- Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (ICESCR), 1966
- Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të gjitha formave të Diskriminimit Racor (ICERD), 1965
- Konventa kundër Torturës dhe trajtimeve ose ndëshkimeve të tjera mizore, jonjerëzore ose degraduese (CAT), 1984
- Konventa mbi Eliminimin e të gjitha formave të Diskriminimit kundër Grave (CEDAW), 1979
- Konventa e të Drejtave të Fëmijës (CRC), 1989 (Neni 2)
- Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO) Konventa Nr. 111, 1958

#### *Instrumentet ligjore rajonale:*

- Evropë
- Konventa Evropiane për të Drejta të Njeriut (ECHR), 1953
- Traktati i Funkcionimit të Bashkimit Evropian (TFEU), 2010

- Karta e të Drejtave Fundamentale e Bashkimit Evropian, 2000
- Legjislacioni sekondar i BE-së: Direktiva e Këshillit 2000/78/EC që themelon një kornizë të përgjithshme për trajtim të barabartë në punësim dhe profesion, 2004/113/EC, 2006/54/EC, 2004/83/EC, 2011/0129 (Paketa e të Drejtave të Viktimave), "Direktiva 2012/29/EU, e cila themelon standardet minimale për të drejtat, përkrahjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimit, dhe zëvendësimi i Vendimit Kornizë të Këshillit 2001/220/JHA"

#### *Deklarata:*

- Deklarata Universale për të Drejta të Njeriut, 1948
- Deklarata e OKB-së për të Drejtën dhe Përgjegjësinë e Individëve, Grupeve dhe organeve të shoqërisë për të promovuar dhe mbrojtur të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Fundamentale që njihen në nivel universal, 1999

#### *Dokumente të tjera rajonale:*

- Standardet e Këshillit të Evropës 'Luftimi i diskriminimit në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor', 2011
- Këshilli i Evropës 'Rekomandimi për masat e luftimit të diskriminimit në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor', 2010

- Rezoluta OAS 'Të drejtat e njeriut, orientimi seksual dhe identiteti gjinor', 2008
- Rezoluta OAS mbi 'Të drejtat e njeriut, orientimin seksual dhe identitetin gjinor në shtetet e Amerikës', 2009

#### Deklarata dhe Rezoluta

- Deklarata e përbashkët e UN HRC për orientimin seksual, identitetin gjinor dhe të drejtat e njeriut, dhjetor 2006;
- Deklarata e UNGA për të drejtat e njeriut, orientimin seksual dhe identitetin gjinor, 2008;
- Deklarata e Përbashkët e UN HRC 'Ndalimi i Akteve të Dhunës dhe Shkeljet e të Drejtave të Njeriut në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor', mars 2011;
- Rezoluta e HRC "Të drejtat e njeriut, orientimi seksual dhe identiteti gjinor" (HRC/17/L.9/Rev.1); Raporti i Komisionerit të OKB-së për të Drejta të Njeriut – Studim që dokumenton ligjet dhe praksat diskriminuese dhe aktet e dhunës kundër individëve, në bazë të orientimit të tyre seksual dhe identitetit gjinor,<sup>14</sup> 2011.

#### Dokumente të tjera relevante

- Raporti i Kongresit Botëror për të drejta të njeriut, orientim seksual dhe identitet gjinor, 2009
- Të lindur të lirë dhe të barabartë, orientimi seksual dhe identiteti gjinor në të Drejtën

Ndërkombëtare për të Drejta të Njeriut, OHCHR, 2012

- Udhëzimet e UNHCR-së për Mbrojtje Ndërkombëtare Nr.9: "Kërkesat për Status të Refugjatit, në bazë të Orientimit Seksual dhe/ose Identitetit Gjinor në kontekst të Nenit 1A(2) të Konventës së vitit 1951 dhe/ose Protokolit të saj të vitit 1967 që ka të bëjë me Statusin e Refugjatëve", 23 tetor 2012
- "Anketa Evropiane LGBTI" e Agjencisë për të Drejta Fundamentale, maj 2013
- Këshilli i Komitetit Evropian për Barazi dhe Jodiskriminim "Trajtimi i diskriminimit, në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor", Memorandum i korigjuar, 15 mars 2013
- Parimet nga Yogyakarta për zbatimin e të Drejtës Ndërkombëtare për të Drejta të Njeriut, lidhur me orientimin seksual dhe identitetin gjinor, 2006

## SHTOJCA 2

### Elementet për analizë/lista e plotë e situatës që ka të bëjë me çështjet e të drejtave të njeriut për LGBTI:

Çështja e të drejtave të njeriut	Tregues	Burime të informatave
<b>1. E drejta për jetë</b>		
1.1. A përdoret dënimi me vdekje për të ndëshkuar marrëdhëniet e gjinisë së njëjtë? A zbatohet legjislacioni (hetimet e policisë dhe/ ose dënimet e gjykatave)?	A parasheh ligji dënimin me vdekje për miratimin e marrëdhënieve të gjinisë së njëjtë? A zbatohet legjislacioni (hetimet e policisë dhe/ ose dënimet e gjykatave)?	Kodi penal; Raportet e gazetave; statistikat e krimin; OJQ-të, bllogjet dhe faqet e internetit.
1.2 A janë personat LGBTI në shënjestër për vrasje jashtë-gjyqësore në bazë të orientimit të tyre seksual ose identitetit gjinor?	A ekzistojnë raporte të besueshme për vrasjen apo kërcënimin me vrasje të personave LGBTI nga policia ose me involvimin e tyre apo të zyrtarëve të tjerë të sigurimit? A janë hetuar dhe a janë ndjekur penalisht rastet e këtilla?	Raportet e Raportuesve Specialë të OKB-së ose përfaqësues të tjerë të organizatave ndërkombëtare, dëshmitë; raportet e gazetave; OJQ-të, bllogjet dhe faqet e internetit.
<b>2. E drejta e lirisë nga tortura ose trajtimi mizor, johuman ose degradues</b>		
2.1 A i nënshtrohen personat LGBTI në mënyrë sistematike dhe diskriminuese torturës dhe keqpërdorimit nga policia ose forca të tjera të sigurimit?	A ekzistojnë raporte të besueshme për torturimin ose keqpërdorimin e personave LGBTI nga policia ose forca të tjera të sigurimit gjatë hetimeve ose paraburgimit? A janë hetuar dhe ndjekur penalisht rastet e këtilla?	Raportet e Raportuesve Specialë të OKB-së ose përfaqësues të tjerë të organizatave ndërkombëtare; raportet e mekanizmave vizitues, siç janë Mekanizmat Preventivë Nacionalë (NPM), Nënkomiteti për Parandalimin e Torturës (SPT), Komiteti i Këshillit Evropian kundër torturës (CPT), dhe Institucionet e të Drejtave të Njeriut (NHRI), dëshmitë; raportet e gazetave; OJQ-të, bllogjet dhe faqet e internetit.
2.2 A ofron policia dhe zyrtarët e tjerë të sigurimit mbrojtje të duhur për personat LGBTI?	A hetohen dhe a ndiqen penalisht krimet e dhunshme kundër personave LGBTI?	Raportet e mekanizmave vizitues, siç janë NPM, SPT, CPT dhe NHRI, dëshmitë; raportet e gazetave; statistikat e krimin; OJQ-të, bllogjet dhe faqet e internetit.

2.3 A ofrojnë mbrojtje të duhur autoritetet e paraburgosur LGBTBI?	Kur është nevoja, a merren masat e domosdoshme për të mbrojtur të paraburgosurit LGBTBI nga keqpërdorimet që i bëjnë të paraburgosurit e tjerë? A bëhet kjo me pëlqimin e informuar të personave në fjalë?	Raportet e mekanizmave vizitues, siç janë NPM, SPT, CPT dhe NHRI, dëshmitë; raportet e gazetave; statistikave të kriminologjisë; OJQ-të, blogjet dhe faqet e internetit.
3.1 A kanë personat LGBTBI mbrojtje të barabartë dhe efektive para ligjit nga diskriminimi?	A diskriminon legjislati në bazë të orientimit seksual ose identitetit gjinor? A përfshin ligji kundër diskriminimit orientimin seksual dhe identitetin gjinor? A zbatohet ky legjislacion nga sistemi ligjor (p.sh. policia dhe sistemi i gjykatave)?	Dëshmitë; legjislati anti-diskriminues; kodet e përgjithshme ligjore; asociacionet ligjore; OJQ-të, blogjet dhe faqet e internetit.
<b>4. E drejta e barazisë dhe mos-diskriminimit</b>		
4.1 A përdoret e drejta penale për të ndëshkuar marrëdhëniet e gjinisë së njëjtë ose identiteteve transeksuale?	A arreston policia persona që dyshohen se kanë marrëdhënie të gjinisë së njëjtë? A gjykohe dhe a dënohen njerëzit për marrëdhëniet e këtyra? A arreston ose a dënon policia në bazë të veshjeve që korrespondojnë me gjininë tjetër ose identitetit të tyre transeksual?	Kodi penal; dëshmitë; raportet e gazetave; statistika e kriminologjisë; OJQ-të, blogjet dhe faqet e internetit.
4.2 A ekzistojnë ligje që kanë të bëjnë me moralin ose rendin publik që përdoren për të bërë të paligjshme marrëdhëniet e gjinisë së njëjtë?	Autoritetet, a bastisin festat private ose a i parandalojnë njerëzit që shpallin reklama në faqe të internetit për të gjetur shoqëruar?	Kodi penal; dëshmitë; raportet e gazetave; OJQ-të; grupet LGBTI, shoqatat e avokatëve.
4.3 A ekzistojnë dallime në ligjet për heteroseksualitet dhe homoseksualitet, siç janë mosha e dhënies së pëlqimit ose përcaktimi i mjedisit privat ose publik? A zbatohen këto ligje?	A ekzistojnë hetime dhe/ose ndjekje penale? A dënohen të rinjtë për aktet e gjinisë së njëjtë nën moshën e pëlqimit, ndërsa nuk do të ishin dënuar për aktet seksuale me gjininë e kundërt?	Kodi penal; dëshmitë; raportet e gazetave dhe të faqeve të internetit mi rastet gjyqësore; OJQ-të; grupet LGBTI.

4.4 A ekzistojnë procedura për pranimin e identitetit gjinor të një personi transeksual ose interseksual në dokumente zyrtare?	A e lejon këtë ligji dhe rregullativa administrative? A janë këto procedura të qasshme, transparente, të shpejta dhe pa kërkesa abuzive mjekësore dhe sociale? A garantohet se privatësia është e mbrojtur me ndalimin e zbulimit të historisë ligjore të gjinisë së personit? A parashihet që aktorët shtetërorë dhe jo-shtetërorë të ndryshojnë gjininë në referencat e punës, certifikatat dhe ngjashëm?	Agjencitë zyrtare të regjistrimit; OJQ-të, grupet LGBTI.
4.5 A mundet një person transeksual ose interseksual të gëzojë të gjitha të drejtat e gjinisë së tij/saj të ricaktuar?	Nga perspektiva ligjore, a trajtohet një person transeksual ose interseksual që ka ndërruar gjininë e tij/saj njëjloj si çdo person tjetër i gjinisë së njëjtë?	Asociacionet ligjore; Autoritetet relevante.
<b>5. E drejta e asociacionit</b>		
5.1. A mundet personat LGBTBI të themelojnë asociacione për përfaqësimin e interesave të tyre?	A i ndalon ligji asociacionet e këtyra? Nëse jo, a përjashtohen ato nga ligji në mënyrë efektive me anë të shqetësimit zyrtar? A përfshin anëtarësimi pasoja negative për anëtarët? A ndjehen asociacionet të obliguara të fshehin vepërimitarinë e tyre të vërtetë, duke përdorur eufemizma?	Ligji mbi OJQ-të / asociacionet; ekzistimi i faqeve të internetit; raportet e OJQ-ve, grupet LGBTI; sindikatet.
<b>6. Liria e tubimit</b>		
6.1 A mund të organizojnë shoqatat LGBTBI evente publike dhe jo-publike, të tilla si Paradat Gay Pride, evente kulturore dhe sociale, dhe konferenca	Këto evente, a mbahen pa pengesa të tepruara politike dhe administrative? A i mbron policia eventet nëse ekziston armiqësi publike? A ushtrohet presion mbi pronarët që të mos i huazojnë objektet e tyre për evente LGBTBI?	Ligji mbi asambltetë; Raportet e lajmeve; raportet e OJQ-ve; faqet e internetit të lirive civile kolake / grupet LGBTI.

<b>7. Liria e informimit dhe liria e të shprehurit</b>		
7.1 A lejon ligji paraqitjen e temave LGTBI në revista/ faqe të internetit/ radio/ televizion/ programe/ filme? A mund të operojnë këto në mënyrë efektive?	A janë revistat në dispozicion në shitje publike? A mund të përmbajnë programet e radios, televizionit dhe filmat aspekte të jetës LGBTI? Raportimi i çështjeve LGBTI, a ka për qëllim të jetë informativ apo të nxisë urrejtje? A ekziston presion zyrtar mbi distributorët dhe transmetuesit për të dekurajuar imazhet pozitive të personave?	Shfaqja në gazetat në gjithë vendin; raportet e gazetave dhe faqeve të internetit; të drejtat e njeriut dhe raportet e OJQ-ve për LGBTI; diskutime me grupet mediatike.
<b>8. E drejta e punës</b>		
8.1. A vuajnë njerëzit nga diskriminimi në punë, në bazë të orientimit seksual ose identitetit gjinor?	A ekziston ndonjë mbrojtje ligjore nga diskriminimi në bazë të orientimit seksual ose identitetit gjinor? A është shpalosja e orientimit seksual një element/ pengesë e rëndësishme në vendin e punës? A shkarkohen ata ligjërisht kur zbulohet statusi i tyre LGBTI?	Dëshmitë; Raportet e gazetave dhe faqeve të internetit; grupet LGBTI dhe bllogjet; sindikatet.
<b>9. E drejta e shëndetit</b>		
9.1 A gëzojnë personat LGBTI qasje të barabartë në objektet shëndetësore për çështje relevante për ata?	A ekziston qasja në shërbime konfidenciale dhe të përshtatshme për personat LGBTI? A janë ofruarit e kujdesit shëndetësor të trajnuar për të ofruar kujdes shëndetësor pa paragjykimet për personat LGBTI? A ekzistojnë informata të duhura për mbrojtjen nga HIV/SIDA/ sëmundjet ngjitëse seksuale, të cilat synohen për ata? Ligjet anësore, a e parandalojnë apo a e vështirësojnë qasjen e personave LGBTI në objektet shëndetësore? A u refuzohen personave LGBTI shërbime të caktuara shëndetësore, p.sh. kujdesi shëndetësor riprodhues për lezbiket, dhurimi i gjakut për meshkujt gej dhe biseksualë?	Grupet LGBTI; asociacionet profesionale mjekësore; ministria e shëndetësisë.

9.2 A është në dispozicion rikonstruimi gjinor?	A janë në dispozicion shërbimet psikologjike, endokrinologjike dhe të rikonstruimit gjinor në vend apo a mundësohet trajtimi jashtë vendit? A ofrohen këto shërbime pa trajtim diskriminues dhe degradues, pavarësisht nga statusi martesor, ligjor ose çdo lloj statusi tjetër jo-mjekësor dhe në bazë të pëlqimit të informuar të personit në fjalë? Skemat e sigurimit dhe kujdesit shëndetësor, a kufizojnë ose refuzojnë mbulimin e shpenzimeve për këtë lloj të trajtimit, në bazë diskriminuese? A janë në dispozicion informatat lidhur me këto shërbime?	Ministria e shëndetësisë; Asociacionet profesionale të mjekëve dhe psikiatërve; organizatat e pacientëve; grupet LGBTI.
<b>10. Të drejtat e fëmijëve</b>		
10.1 A vuajnë fëmijët nga diskriminimi si pasojë e orientimit seksual ose identitetit gjinor?	A janë fëmijët të diskriminuar për shkak të orientimit të tyre seksual ose identitetit gjinor? A ka ndikim negativ orientimi seksual ose identiteti gjinor i një prindi LGBTI mbi statusin e fëmijëve të tij apo të saj? A ekzistojnë procedura që u mundësojnë personave të mitur transgjinorë të shprehin identitetin e tyre gjinor dhe të jetojnë në përputhje me rrethanat? A i nënshtrohen fëmijët kirurgjisë së panevojshme mjekësore që kryhet pa pëlqimin e tyre të informuar, ose atë të prindërve të tyre, në përpjekje për të 'rregulluar' gjininë e tyre?	Legjislacioni anti-diskriminues; ligjet për të drejtat e fëmijëve; ligjet e kujdestarisë, trashëgimia; asociacionet ligjore; Të drejtat e fëmijëve dhe OJQ-të LGBTI.
<b>11. E drejta e arsimit</b>		
11.1 A vuajnë personat LGBTI nga diskriminimi në të drejtën e arsimit, në bazë të orientimit seksual ose identitetit gjinor?	A gëzojnë personat LGBTI të drejtën e arsimit në mjedis të sigurtë, pa ngacmime, pa dhunë, përjashtim social ose forma të tjera të trajtimit diskriminues dhe degradues që ka të bëjë me orientimin seksual ose identitetin gjinor?	Grupet LGBTI; bordet shkollore; dëshmitë, raportet e faqeve të internetit, ministria e arsimit.



1. Shih edhe paragrafin 5 të Deklaratës së Vienës dhe Programit të Veprimit, të miratuar në Konferencën Botërore për të Drejta të Njeriut në vitin 1993 (UN doc A/CONF.157/23): "Ndërsa duhet të merren parasysh rëndësia e karakteristikave nacionale dhe rajonale dhe sfondet e ndryshme historike, kulturore dhe fetare, Shtetet janë të obliguara, pavarësisht nga sistemet e tyre politike, ekonomike dhe kulturore, të promovojnë dhe të mbrojnë të gjitha të drejtat njerëzore dhe liritë fundamentale."
2. ICCPR, Neni 2 (1): ("Çdo Palë Shtetërore e Marrëveshjes aktuale merr përsipër të respektojë dhe të garantojë të drejtat që njihen me këtë Marrëveshje, për të gjithë individët brenda territorit të vet dhe që i nënshtrohen jurisdiksionit të tij, pa asnjë dallim, siç është raca, ngjyra, gjinia, gjuha, feja, opinioni politik ose ndonjë opinion tjetër, origjina kombëtare dhe sociale, prona, statusi i lindjes ose ndonjë status tjetër").
3. ICCPR, Neni 26 ("Të gjithë personat janë të barabartë para ligjit dhe kanë të drejtë, pa asnjë diskriminim, për mbrojtje të barabartë të ligjit. Në këtë drejtim, ligji do të ndalojë çdo diskriminim dhe do t'u garantojë të gjithëve mbrojtje të barabartë dhe efektive nga diskriminimi në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, opinionit politik ose opinionit tjetër, në bazë të origjinës nacionale ose sociale, pronës, statusit të lindjes ose ndonjë statusi tjetër").
4. ICESCR, Neni 2 (2) ("Palët Shtetërore të Marrëveshjes aktuale marrin përsipër të garantojnë se të drejtat e parashtruara në Marrëveshjen aktuale do të ushtrohen pa diskriminim të çfarëdo lloji, të ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, opinionit publik ose ndonjë opinion tjetër, origjinës nacionale ose sociale, pronës, lidhjes ose ndonjë statusi tjetër").
5. Teksti i plotë në <http://www.droitsLGBTI2008.fr/documents/?mode=download&id=2>
6. [http://www.ohchr.org/english/bodies/hrcouncil/docs/19session/A.HRC.19.41\\_English.pdf](http://www.ohchr.org/english/bodies/hrcouncil/docs/19session/A.HRC.19.41_English.pdf)
7. Rekomandimi CM/Rec (2010)5 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare, lidhur me masat për të luftuar diskriminimin në bazë të orientimit seksual ose identitetit gjinor, miratuar pa vota, më 31 mars 2010.
8. Shih p.sh. Raporti i Komisionit të Lartë të OKB-së për të Drejta të Njeriut "Ligjet diskriminuese dhe përvojat dhe aktet e dhunës kundër individëve, në bazë të orientimit të tyre seksual dhe identitetit gjinor", U Doc. A/HRC/19/41 të datës 17 nëntor 2011
9. Shih p.sh. Raportin e Raportuesit Special mbi torturën dhe trajtime të tjera mizore, johumane dhe degraduese ose dënim, U Doc.A/HRC/22/53 nga 1 shkurti 2013.
10. Shih p.sh. Komiteti për të Drejta Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, Koment i Përgjithshëm o.20, mbi Diskriminimin e të drejtave Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (nen. 2, para. 2), U Doc. E/C.12/GC/20, 10 qershor 2009.
11. Shih p.sh. Komisioneri për të Drejta të Njeriut i KiE, Thomas Hammarberg, "Koha është që të pranohet se parimet e të drejtave të njeriut vlejnë edhe për orientimin seksual dhe identitetin gjinor", 14 maj 2008, në: [http://www.coe.int/t/commissioner/Viewpoints/080514\\_en.asp](http://www.coe.int/t/commissioner/Viewpoints/080514_en.asp)

12. Shih Udhëzimin e UNHCR lidhur me "Punën me personat LGBTI në zhvendosjen e detyruar", 2011, f.3: <http://www.refworld.org/cgi-bin/txis/vtx/rwmain?docid=4e6073972>. Këto definicione nuk janë ligjërish të detyrueshme dhe nuk janë miratuar zyrtarisht nga ndonjë organ ndërqeveritar; ato përfshihen për të ofruar udhëzime praktike për zyrtarët e institucioneve të BE-së dhe Shtetet Anëtare të BE-së, të cilët punojnë lidhur me çështjet LGBTI. Shih gjithashtë Udhëzimet e UNHCR për Mbrojtje Ndërkombëtare o.9: "Kërkesat për statusin e refugjatit në bazë të orientimit seksual dhe /ose identitetit gjinor në suaza të kontekstit të Nenit 1A(2) të Konventës së vitit 1951 dhe/ose Protokolit të saj të vitit 1967 që ka të bëjë me statusin e refugjatëve", HCR/GIP/12/09 nga 23 tetori 2012, f.4

13. A/HRC/19/41

14. [http://www.ohchr.org/english/bodies/hrcouncil/docs/19session/A.HRC.19.41\\_English.pdf](http://www.ohchr.org/english/bodies/hrcouncil/docs/19session/A.HRC.19.41_English.pdf)







CONSILIUM

<http://www.consilium.europa.eu>